

Interpretimi/përkthimi në realitetin virtual.

*Zhvillimi i aplikacioneve të
përkthimit online si dhe trajnimi i
stafit dhe studentëve me
teknologjinë e re.*



Qëllimi

- Qëllimi i këtij projekti është vlerësimi i ofertës akademike të Departamentit të Gjuhës Gjermane/ Fakultetit të Gjuhëve të Huaja UT në programet e studimit *Master në Përkthim* nga pikëpamja e aftësive dhe kompetencave me të cilat ato pajisin studentët e tyre si dhe kurrikulave që ato ofrojnë krahasuar me atë çka kërkon sot tregu i punës në këtë sektor, veçanërisht në fushën e interpretimit/ përkthimit virtual.

Qëllimi

- Ky projekt kërkimor synon evidentimin e nevojave të studentëve të ciklit të dytë të studimeve Master në përkthim, të cilët pas përfundimit të cikleve përkatëse të studimeve pritet të përbëjnë kontigjentin e përkthyesve të ardhshëm në institucionet tona. Nëpërmjet këtij projekti, kjo kategori studentësh ka si synim të prezantohet, informohet e trajnohet mbi interpretimin/ përkthimin në distancë si dhe zhvillimit të kapaciteteve të tyre gjatë viteve akademike për t'i paraprirë situatave globale.

Argumentimi

- Iniciativa e grupit të punës për të propozuar një projekt në fushën e përkthimit virtual me fokus zhvillimin e aplikacioneve për implementimin e këtij lloj përkthimi është në përputhje të plotë me Strategjinë për Arsimin e Lartë për kërkesat për zhvillim teknologjie dhe inovacion
- Ky projekt synon të transmetojë kompetenca që u nevojiten studentëve për t'iu përshtatur situatës reale në tregun e punës, në kushtet e një zhvillimi shumë të shpejtë të teknologjisë, ku edhe përkthimi virtual po zë një vend shumë të rëndësishëm në shumë institucione
- Projekti kombinon dhe u ofron studentëve, por jo vetëm, shansin dhe mundësinë e një formimi më të gjerë dhe aftësinë për të aplikuar metoda shkencore më të avancuara dhe aplikacione të cilat janë bërë të domosdoshme në tregun europian.

Argumentimi

- Studentët e interpretimit/ përkthimit kanë nevojë për mundësi adekuate të vetë-studimit dhe burime të të mësuarit që do t'i lejonin ata të mësojnë dhe të praktikojnë interpretimin në mjedise të ndryshme komunikimi.
- Mjetet/ aplikacionet CAIT (computer-assisted interpreter training) zakonisht „shihen si një integrim i dobishëm me metodat tradicionale”. Megjithatë, zbatimi i mjeteve të tilla softuerike kërkon një ndryshim në qasjen arsimore. Në këtë projekt ne fillimisht specifikojmë se cilat mjete CAIT mund të përdoren për të trajnuar aftësi të veçanta në mjedise të caktuara dhe në cilën fazë së interpretimit (përgatitje, interpretim, reflektim)

Argumentimi

- Në kushtet e sotme është i domosdoshëm ndryshimi dhe përafrimi i legjislacionit të sistemit të lartë arsimor shqiptar me atë evropian, i cili parasheh studimet shumëdisiplinore parësore.
- Besojmë se projekti që propozojmë shpreh dhe garanton përpjekjet dhe investimin më të mirë të kapaciteve në departamentin e gjuhës gjermane, duke u bazuar në ato që konsiderojmë si pikat më të forta të tij: 1) *raport racional dhe efikas midis teorisë dhe praktikës*, duke i dhënë më shumë prioritet aplikimit të njohurive teorike në praktikë dhe përdorimin e tyre në situata reale në jetën profesionale. 2) *ndërthurje harmonike midis disiplinave të ndryshme*, 3) *risi të konceptualizimit të përkthimit* duke përfshirë aktivitete në shërbim të tij. 3) *kompletimin e aftësive dixhitale të studenteve*

Argumentimi

- Burimet hyrëse për të hartuar këtë projekt janë marrë duke filluar nga Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Planit për Zhvillim Ekonomik Kombëtar, Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin si dhe pikëpamjet e biznesit privat në Shqipëri. Në hartimin e projektit është marrë parasysh edhe krijimi i infrastrukturës moderne dhe të stafit akademik me eksperiencë dhe njohuri shumë të mira nga fusha e *përkthimit*.
- Grupi i punës që propozon këtë projekt ka dhe përvoja të shumta të mëparshme me implimentimin e projekteve shkencore. Gjithashtu egziston dhe një përvoje tjetër në fushën e përkthimit virtual e cila është bërë e mundur nga projekti READ (AADF) [i fituar tashme, me zbatim në departamentin e gjuhës gjermane] që vërtetë ka një fokus dhe qasje tjetër si dhe objektiva të tjera por rezultatet nga ky projekt do të mund të na shërbejnë si tregues të vlefshëm për një zbatim sa më të lehtë dhe efikas të projektit të propozuar.
- VALUE-X (gjithashtu projekt në fushën e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie)
- Bashkëpunimi me universitete të huaja (Dresden. Kopenhagen)

Objektivat e projektit

- (a) Analiza e praktikave më të mira për të eksploruar përdorimet aktuale të TIK-ut në fushën e trajnimit të përkthyesve
- (b) Projektimi dhe ndërtimi i mjedisit virtual dhe skenarëve të tij interpretues [zhvillimi teknik];
- (c) Krijimi i përmbajtjes dhe aktiviteteve për skenarët e interpretimit,
- (d) Sigurimi i qëndrueshmërisë afatgjatë i projektit nëpërmjet integritit në programet e trajnimit të përkthyesve, shtrirjes në kontekste të tjera të arsimit të lartë, dhe transferimit në kontekste të tjera kërkimore [zbatimi].

Platformat virtuale

- Gjithshtu projekti synon në përvetësimin e platformave të ndryshme të përkthimit virtual si:
- CAIT tools
- *Websites ORCIT (Online Resources for Conference Interpreter Training)*
- *Interpreter Training Resources*
- *National Network for Interpreting (NNI)*
- *Video corpora*
- *ELISA*
- *Backbone*
- *Interpreter training software*
- *Black Box*
- *Interpreter training in virtual environments IVY*
- *Videoconferencing tools*
- *Google Hangout*
- *E-learning platforms (Course Management Systems)*
- *Moodle*

Analiza e grupeve të synuara dhe e palëve të interesit nga projekti

Analiza e grupeve të synuara dhe e palëve të interesit nga projekti

- Përfituesit direkt
- Në përfundim të këtij projekti përfituesit direkt të tij do të jenë pikërisht studentët e Ciklit të dytë të studimeve *Master në Përkthim*. Kjo kategori studentësh, si kontigjenti i përkthyesve të së ardhmes përbën kategorinë kryesore përfituese të trajnimeve të këtij projekti.
-
- Përfituesit indirekt
- Një kategori tjetër përfituese indirekte janë dhe kolegët e universiteteve të tjera të cilët mund të përdorin një tematikë të tillë për të rritur kapacitetet e studentëve të tyre në fusha të caktuara.

Rezultatet e pritshme

- - Rezultatet e të dhënave të pyetësorëve të cilat janë tregues konkret dhe i matshëm i nevojave të studentëve të ciklit të dytë të studimeve Master në Përkthim
- - Rezultatet përfundimtare të projektit të përfutuara nga studentët pas realizimit të trajnimeve, për të vlerësuar njohuritë e reja të përfutuara tek ata.
- Në përfundim të këtij projekti, studentët e nivelit Master në përkthim do të kenë përvetësuar në një masë të konsiderueshme aftësitë e tyre menaxhuese të platformave të ndryshme dixhitale në funksion të interpretimit/ përkthimit. Në fund të këtij projekti studentët do të mund të jenë prezantuar dhe do kenë perfeksionuar disa prej teknikave praktike për përkthimin online

Produkti/produktet e projektit

- **Si mendohet t'iu bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të tyre?**
- Në përfundim të këtij projekti kërkimor synohet të realizohen aktivitete të ndryshme për të bërë të njohur rezultatet e tij. Një ndër to është hartimi i artikujve shkencor të lidhur me këtë projekt, si dhe publikimi i tyre në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Një mënyrë tjetër mjaft efikase është dhe shkrimi i artikujve informues në grupimet e rrjeteve sociale. Kjo do të përbëntë një ndër format më të shpejta dhe efikase të shpërndarjes së informacionit marrë shkas dhe nga përdorimi i shpeshtë i rrjeteve sociale nga individë të ndryshëm.
- Gjithashtu rezultatet e projektit, bashkangjitur dhe raporti përfundimtar do të mund të publikohen në Website-in e universitetit për të qenë e aksesueshme për një audiencë më të gjerë.

Metodologjia

- Hartimi i metodologjisë përbën një ndër elementët më të rëndësishëm të realizimit të këtij projekti. Ky projekt kërkimor është hartuar në formën e një hulumtimi të strukturuar e të organizuar i cili konsiston në mbledhjen e të dhënave sasiore (në përputhje me numrin e studentëve) e cilësore (bazuar në karakterin e pyetjeve të përfshira në intervista). Në sajë të këtij organizimi të projektit synohet të kuptohet shkalla e qasjes së studentëve ndaj teknologjisë dhe njohja e arsimit të kombinuar, përpunimi i të dhënave, hartimi i raportit përfundimtar të projektit. Si mjet hulumtues i këtij projekti kërkimor do të jetë pikërisht pyetesori dhe intervista, të dhënat e marra do të përpunohen për t'u përfshirë edhe në raportin përfundimtar.
- Lidhur me përzgjedhjen e kampionit do të realizohet në bazë të fokusgrupeve të profilit të degës të studentëve të nivelit Master me drejtim Perkthyes.
- Trajnimet do të konsistojnë në seanca me njohuri të përgjithshme rreth perkthimit virtual dhe në seanca të cilat përshtasin specifikën e programit të studimit të studentëve me specifikën e arsimit të kombinuar në këtë profil. Trajnimet përbëjnë një element të rëndësishëm të realizimit dhe përmbushjes së aktiviteteve të projektit, të cilat do të mbulojnë kryesisht pjesën informuese dhe praktike të tematikave të përzgjedhura.

Analiza e riskut

- Mungesa e një teknologjie të përshtatshme për përkthimin virtual do të sillte pengesa për zbatimin e projektit.
 - Sigurimi i një teknologjie të përshtatshme për sigurimin e përkthimit virtual, për të përdorur në mënyrë adekuate mjetet e duhura të përkthimit virtual.
- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja është pajisur dhe kompletuar në nivel bashkëkohor me mjetet teknologjike, të cilat mendojmë se do të përdoren në kuadrin e projektit

Kontrolli i cilësisë dhe monitorimi

- Matja e aktiviteteve të vazhdueshme të projektit
- Monitorimi i variablave të projektit (kosto, përpjekje, fushëveprimi, etj.) kundrejt planit të menaxhimit të projektit dhe bazës së performancës së projektit (aty ku duhet të jemi);
- Identifikimi i veprimeve korigjuese për të adresuar çështjet dhe rreziqet si duhet (si mund të rikthehemi në rrugën e duhur);
- Ndikimi i faktorëve që mund të shmangin kontrollin e integruar të ndryshimeve, në mënyrë që të zbatohen vetëm ndryshimet e miratuara.

Plani i punës

- **Aktiviteti 1: Prezantimi i projektit** tek stafi akademik dhe të gjithë studentët e përkthimit dhe njohja e tyre me qëllimin dhe objektivat e projektit. Ky aktivitet do të përbëjë dhe hapin e parë të vënies në zbatim të projektit ndaj dhe prezantimi në mënyrë sa më të qartë i objektivave të këtij projekti është tepër i rëndësishëm.
- **Aktiviteti 1.1: Hartimi i pyetësorit** dhe plotësimi i tij nga studentët do të përbëjë dhe aktivitetin e dytë të këtij projekti. Ky aktivitet është i një rëndësie të veçantë për vetë faktin se do të evidentojë konkretisht domosdoshmëritë e studentëve.

Plani i punës

- **Aktiviteti 2: Përpunimi i të dhënave.** Në këtë aktivitet synohet të arrihet përpunimi i të dhënave të gjeneruara nga plotësimi i pyetësorëve lidhur me tematikën e projektit.
- **Aktiviteti 2.2: Hartimi i raportit dhe publikimi i tij.** Ky aktivitet synon pikërisht hartimin e një raporti fillestar rreth problematikave të evidentuara nga plotësimi i pyetësorëve.
- **Aktiviteti 3: Ndjekja e moduleve të trajnimit.** Paraprakisht do të bëhen trajnime për grupin e punës së këtij projekti të cilet do të ofrojnë module në formën e moduleve ekstrakurrikulare për studentët. Hartimi i tyre do të bëhet në përputhje dhe me degën e studimit.
- **Aktiviteti 3.1: Prezantimi dhe realizimi i moduleve të hartuara.** Vënia në zbatim e këtyre moduleve do të realizohet në formën e Workshop-eve (trajnimeve).

Plani i punës

- **Aktiviteti 3.2: Mbledhja e përshtypjeve të studentëve** në lidhje me trajnimet dhe aftësitë e reja të fituara. Studentët do të kenë mundësinë të reflektojnë e të shprehin idetë e tyre në lidhje me përmbajtjen e moduleve dhe mënyrën e zbatimit të këtyre njohurive të reja.
- **Aktiviteti 4: Përgatitja dhe publikimi i një raporti të plotë**, i zhvillimit të projektit, i cili më pas do të publikohet në format hardcopy. Publikimi i një raporti të tillë jo vetëm do të përbëjë produktin përfundimtar të projektit por dhe do të shërbejë si evidencë e kërkimit shkencor të realizuar nëpërmjet tij për të ndryshuar, përmirësuar apo përshtatur mjete dhe elemente të përkthimit, për të qenë në një linjë më atë çfarë kërkon tregu i punës.